



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:031124
Datë: 14.06.2024
Numri i dokumentit: 05821993

CA.nr.6510/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit-propozuesit M.M. nga fshati I..., Komuna Deqan, të cilin me autorizim e përfaqëson A.D., avokat me seli në Komuna Mitrovicë, kundër të paditurit A.B. me vendbanim në Rr. "...", Komuna Pejë, të cilin me autorizim e përfaqëson G.G., avokat me seli në Komuna Prishtinë, në çështjen për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga paditësi-propozuesi i masës së sigurimit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.644/23 datë 25.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 13.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e paditësit M.M. nga fshati I..., Komuna Deqan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.644/2023 datë 25.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar C.nr.644/23 datë 25.04.2023, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

"... REFUZOHET i pabazuar propozimi i paditësit – propozuesit të sigurimit M.M. nga fshati I..., me të cilin kanë kërkuar që "ti ndalohet të paditurit A.B. nga Peja ose personave të autorizuar nga ana e tij, që paluajtshmërinë-banesën e cila evidentohet sipas certifikatës së pronës me nr.të njësisë kadastrale 0-71914059-10015-0-796-2-18-0, në sipërfaqe prej 82.44m2, lloj i njësisë pjesë e ndërtesës vendi i quajtur "....", e cila gjendet në Prishtinë Rr. "...", hyrja ..., banesa nr..., të shfrytëzoj banesën kontestuese

si dhe të lidh çfarëdo marrëdhënie juridike, kontratë të ndërrimit, shitblerjes, dhuratës, hipotekës, mbajtjes së përjetshme, qirasë deri sa për këtë çështje nuk vendoset me aktgjykim të plotfuqishëm...”.

Kundër këtij aktvendimi, brenda afatit të paraparë ligjor ka parashtruar ankesë paditësi - propozuesi i masës së sigurimit, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta prishë dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje apo aktvendimin e ankimuar ta ndryshoj dhe çështjen ta vendos në mënyrë meritore.

Përgjigje në ankesë nuk është parashtruar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit/ve 194, dhe nenit 209 pika d), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore gjeti se:

-Ankesa është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi-propozuesi M.M. nga fshati I..., Komuna Deqan, me datë 03.02.2023, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurit A.B. me vendbanim në Rr. "...", Komuna Pejë, me kërkesë për caktimin e masës së sigurisë.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.644/23 datë 12.04.2023, e ka refuzuar propozimin e paditësit-propozuesit, për caktimin e masës së sigurisë.

Kundër këtij aktvendimi pala paditësi ka parashtruar ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin A.C.nr.3772/2023 datë 05.07.2023, e ka aprovuar ankesën e paditësit-propozuesit, dhe e ka kthyer çështjen në procedim të serishëm.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.644/23 datë 23.11.2023, ka nxjerrë aktvendim me të cilin e ka refuzuar propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurisë.

Kundër aktvendimit C.nr.644/23 datë 23.11.2023, pala paditëse-propozuesi ka parashtruar ankesë.

Gjykata e Apelit të Kosovës me aktvendimin CA.nr.12/2024 datë 31.01.2024, e ka aprovuar ankesën e paditësit-propozuesit dhe e ka kthyer çështjen në procedim të serishëm.

Gjykata e shkallës së parë, në procedim të serishëm pas mbajtjes së seancës kryesore me datë 19.04.2023, dëgjimit të palëve në procedurë, dhe administrimit të provave, ka marrë aktvendim C.nr.644/23 datë 25.04.2024, me të cilin e ka refuzuar

propozimin e paditësit-propozuesit, për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktvendimit të atakuar, ndër të tjera ka arsyetuar se: *“... Duke u nisur nga propozimi i palës paditëse-propozuesi i sigurimit me të cilin ka kërkuar që “ti ndalohej të paditurit, shfrytëzimi, shitja, tjetërsimi apo ngarkimi me çfarëdo barre qoftë në palujtshmërinë lëndore e cila evidentohet me numër të njësisë kadastrale 0-71914059-10015-0-796-2-18-0, në sipërfaqe prej 82.44m², lloj i njësisë pjesë e ndërtesës, vendi i quajtur e cila gjendet në Prishtinë Rr.”...”, hyrja ..., banesa nr...”, del se propozimit nuk i është bashkangjitur asnjë provë relevante mbi bazën e së cilës do të provohej ekzistimi i kontratës së shitblerjes së banesës kontestuese. Ndërsa marrëveshja gojore nuk i plotëson kushtet ligjore për tu vlerësuar si kontratë për bartjen e paluajtshmërisë nga e cila do rrjedhte e drejta subjektive e propozuesit. Nga transferet e pagesave të cilat gjykatës i janë ofruar në gjuhë tu huaja për të cilat është deklaruar propozuesi i sigurimit se të njëjta nuk kanë të bëjnë me transfere eventuale për blerjen e pronës kontestuese por kanë të bëjnë me çështje tjera, e të cilat për gjykatën nuk kanë ndonjë relevancë për ti elaboruar në këtë procedurë. Në prani të këtyre fakteve dhe provave të ofruara propozuesi i sigurimit nuk e ka bërë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive dhe në këtë mënyrë nuk është plotësuar kushti ligjor i paraparë me nenin 297.1 pika a) të LPK-së...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktvendimit, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Në nenin 297 par.1, pika a) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore ndër të tjera thuhet se *“...masa e sigurimit mund të caktohet në rast se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive...”*, në pikën b) ndër të tjera thuhet se *“... duhet të vërtetohet se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së propozuar pala kundërshtare do ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, e sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, dhe në nenin 297 par.2 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore në mënyrë decisive thuhet se *“Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin mbi Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtare me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit”*.

Kushtet ligjore të rregulluara me nenin 297.2, dhe nenin 297 par.1 pika a) dhe b) të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, duhet të përmbushen e pastaj të caktohet masa e sigurimit, ndërsa në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 297 par.1 pika a) dhe b), dhe nenin 297.2 të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Pretendimet ankimore janë në tërësi të pa themelta dhe të pa bazuara me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës, dhe se Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë, pasi që dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaftë i kuartë dhe i kuptueshëm, dhe se pretendimet ankimore kryesisht janë pretendime që kanë të bëjnë me çështjen kryesore, lidhur me vendosjen për kërkesëpadinë, dhe të njëjtat nuk kanë ndonjë rëndësi sa i përket vendosjes për propozimin për masën e sigurisë, dhe janë në tërësi të pa bazuara me prova të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi e në bazë të nenit 209 pika b), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.6510/2024 datë 13.06.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Bujar Muzaqi